

VENDIM
Nr.898, datë 29.12.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E ISH-DEKANIT TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, PROF.DR.KRISTO PANO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për kurimin e ish-dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, Prof.Dr.Kristo Pano.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni i kurimit.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha